

V E N D I M
Nr.76, datë 29.12.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Hilmi Dakli,	Anëtar i	“““
Zija Vuci,	Anëtar i	“““
Hajredin Fuga,	Anëtar i	“““
Alfred Karamuço,	Anëtar i	“““
Kujtim Puto,	Anëtar i	“““
Sokol Sadushi,	Anëtar i	“““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	“““

me sekretare Arta Palushi e Drita Filto, më datat 5.10.1998; 12.1.1998 dhe 12.11.1998, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.48 Akti që i përket:

KERKUES:HAMIT KAPLLANI, I përfaqësuar nga avokat Vasil Plaku.

SUBJEKT I INTERESUAR : XHEVAT KUÇI, i përfaqësuar nga avokat Kujtim Capo.

O B J E K T I :

Deklarimin antikushtetues të dy vendimeve nr.1440, datë 19.10.1995 dhe vendimit nr.480, datë 9.4.1998 të Gjykatës së Kasacionit.

Kërkuesi, ka parashtruar këto shkaqe për antikushtetutshmërinë e vendimeve të Gjykatës së Kasacionit:

Dhënia e dy vendimeve gjyqësore me përmbajtje të ndryshme për të njëjtën çështje dhe në të njëjtën datë është antikushtetues, sepse shkel kërkesat e nenit 38 të Ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”.

Gjykata e Kasacionit me vendimin e fundit datë 9.4.1998 ka lënë në fuqi vendimet e gjykatave të rrethit dhe të Apelit, me një proces jo të rregullt ligjor, sepse nuk ka patur dosje.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relacionin përkatës, kërkuesin, subjektin e interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V E R E N:

Kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit, më datë 19.10.1995 ka shqyrtuar çështjen civile me palë : Paditësa, Nikoll Gjini dhe Xhevdet Kuçi; E Paditur, Agjencia e Privatizimit, dega Pukë; Person i Tretë, Hamit Kapllani, me objekt pavlefshmërinë e veprimit juridik të shitjes së lokalit “Bufe Pallati”, Pukë.

Sipas pretendimeve të kërkuesit të konfirmuara gjatë shqyrtimit të çështjes në këtë Gjykatë, rezulton se kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit për këtë rast ka dhënë dy vendime me përmbajtje të ndryshme, por me të njëjtin numër e datë, me po atë objekt dhe shkak dhe me pjesëmarrjen e të njëjtave palë. Kështu, me vendimin nr.1440, datë 19.10.1995, kolegji civil ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.3389, datë 28.7.1995 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Ndërsa me vendimin tjetër me të njëjtin numër e datë, palë e objekt, kolegji civil ka vendosur prishjen e vendimit nr.219, datë 30.5.1995 të gjykatës së rrethit Pukë dhe nr.3389, datë 28.7.1995 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e rrethit Pukë.

Gjykata e Kasacionit duke dhënë dy vendime të ndryshme për të njëjtën çështje, ka zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor, pjesë e të cilit është edhe vendimi gjyqësor, pra ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 38 të Ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 për “Për një shtojcë në Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.

Dhënia e dy vendimeve të ndryshme për të njëjtën çështje, nuk është një shkelje formale, por një cënim i rëndë i parimeve kushtetuese të dhënies së drejtësisë dhe garantimit të një procesi të

rregullt ligjor. Në nenin 2 të Ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Organizimi i Drejtësisë dhe Gjykata Kushtetuese”, thuhet se : “Gjykata është autoriteti që zgjidh çështjet dhe mosmarrëveshjet që lidhen me zbatimin e Ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese” dhe të ligjeve...pas një procesi të drejtë, të barabartë dhe të rregullt ligjor në pajtim me standartet ndërkombëtare”.

Meqënëse vendimi është sintezë e gjithë gjykimit nuk mund të quhet proces i drejtë dhe i rregullt ligjor kur jepen njëkohësisht dy vendime të ndryshme për të njëjtën çështje gjyqësore.

Në bazë të vendimit të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit që kthente çështjen për rigjykim, ajo u rigjykua në gjykatën e rrethit Shkodër (ku u transferua) dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila la në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit. Kërkuesi Hamit Kapllani, me cilësinë e personit të tretë në gjykim, ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Kasacionit, kundër vendimit të Gjykatës së Apelit. Kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit, që e shqyrtoi çështjen pa patur dosje, sepse ajo ishte djegur në trazirat e marsit 1997 të ndodhura në Shkodër, me vendimin datë 9.4.1998 ka lënë në fuqi vendimet gjyqësore të shkallës së parë dhe të Apelit.

Edhe ky vendim i kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit, është antikushtetues dhe procesi është nul, sepse bazohet mbi dy vendimet e tjera të këtij kolegji që u përmendën më lart dhe që janë antikushtetuese.

Në rrethanat që janë krijuar nga dhënia e këtyre vendimeve me përmbajtje antikushtetuese të cilat nuk kanë fuqi juridike dhe në mungesë të dosjes, i takon Gjykatës së Kasacionit që të vendosë për disponimin e çështjes për t’u dhënë mundësi palëve të parashetrojnë nga fillimi kërkesat dhe pretendimet e tyre.

Në këto kushte vendimet e Gjykatës së kasacionit janë antikushtetuese dhe kanë shkelur drejtpërsëdrejti interesat e shtetasve për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor sipas nenit 38 të Ligjit “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”.

PER KETO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 24 të Ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” dhe nenit 41 të Ligjit nr.8373, datë 15.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I :

Shpalljen antikushtetues të dy vendimeve nr.1440, datë 19.10.1995 dhe vendimit nr.480, datë 9.4.1998 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, më 29.12.1998

Nr. 48 i regjistrimit themeltar

Nr. 76 i vendimit.